





Disa këshilla praktike për një internet të sigurt në shtëpitë tuaja

Pajisjet elektronike mund të përmirësojnë mënyrën se si jetojmë dhe punojmë, megjithatë çdo gjë që është e lidhur me internetin mund të jetë e ndjeshme ndaj sulmeve nga hakerat. Këtu janë disa hapa që mund të ndërmerrni për një internet të sigurt në shtëpitë tuaja



1. Siguroni të gjitha pajisjet tuaja

Sigurohuni që të gjitha pajisjet tuaja të mbrohen me fjalëkalime të forta ose konfiguroni vërtetimin me dy faktorë (2FA) i cili është i disponueshëm në shumicën e pajisjeve .



Ju gjithashtu duhet të ndryshoni *fjalëkalimin e paracaktuar* dhe emrin e rrjetit të internetit tuaj. Është e rëndësishme të mbani mend që të mos përfshini asgjë në emrin e rrjetit tuaj që jep ndonjë informacion për shtëpinë ose familjen tuaj, për shembull emrin ose adresën.

2. Kontrolloni aplikacionet tuaja

Shkarkimi i aplikacioneve direkt nga *dyqani zyrtar i aplikacioneve* (Google Play, Apple App Store etj.) është mënyra më e sigurt. Klikimi në një link të rastësishëm për të shkarkuar një aplikacion mund të çojë në infektimin e pajisjes suaj.

Konsideroni me kujdes se çfarë informacioni *lejoni* të aksesohet përpara se të instaloni.


Rishikoni rregullisht aplikacionet tuaja dhe fshini atë që është e panevojshme.



3. Rishikoni cilësimet e privatësisë në llogaritë tuaja të mediave sociale

Shkoni te *cilësimet e privatësisë* së llogarisë suaj dhe aty mund të zgjidhni cilësimet të cilat ju përshtaten.


Mendoni me kujdes se çfarë informacioni duhet të përfshini në profilin tuaj, platformat sociale mund të kërkojnë informacione që ju nuk keni nevojë t'i ekspozoni.



4. Vendosni përditësimet automatike në të gjitha pajisjet dhe bëjini back up të dhënave tuaja

Pajisjet janë të prekshme ndaj sulmeve nga hakerat, kështu që të kesh *përditësimet* më të fundit është një pjesë jetike për të mbajtur pajisjet tuaja të sigurt.

Sigurohuni që të ruani një *kopje* të asaj që është e rëndësishme për ju jashtë rrjetit të internetit ose në platformat cloud.



5. Mbani të ndara pajisjet tuaja të punës dhe shtëpisë

Ne ju sugjerojmë të keni *pajisje të veçanta* për punë dhe shtëpi. Pajisja që përdorni për punë duhet të mbahet vetëm për qëllime pune, kjo do t'ju ndihmojë të minimizoni humbjet nëse pajisja juaj rrezikohet.

